



DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
ZYRA E PROGRAMEVE, MESIMDHENIES & VLERESIMIT
440 North Broad Street
Philadelphia, PA 19130

Veçoritë e Testit Keystone/PSSA dhe Sistemimet, 2018-19

- Do të ketë disa mundësi për të *gjithë* nxënësit gjatë testimit, të tilla si të pasurit e një kohe më të gjatë dhe leximi me zë të lartë, në të gjitha lëndët si në matematikë, shkencë, Algjebra 1, Biologji dhe në disa pjesë të vlerësimit ELA, etj.
- Mundësitë në dispozicion të *gjithë* nxënësve quhen “veçoritë e testit”.
- Opsionet e mundëshme për nxënësit Sp. Ed., EL, dhe ata me Plan 504 *janë të nevojshme* që t'i lejojnë ata të marrin pjesë në testimet nëpërmjet të ashtuquajturave “sistemime”. Kështu që sistemimet janë praktika që ofrojnë qasje të barabarta në teste për këta nxënës.
- Sistemimet ndahen në 4 kategori: Prezantimi, Përgjigja, Ulja (sistemimi) dhe Koha e Testit.
- Të gjitha sistemimet që janë për testet Keystone, janë të vlefshme edhe për ato PSSA.
- **Është me rëndësi të theksohet, se ndonëse disa sistemime janë të duhurat për qëllime mësimore, mund të mos jenë korrekte në testimet e standardizuara.**
- Sistemimet duhet të jenë në përputhje me nevojat e nxënësve; nxënësit duhet të jenë të gatshëm t'i përdorin ato; dhe nxënësit duhet të përfshihen në zgjedhjen e këtyre sistemimeve (Shih “Burimet Shtesë” në Udhëzimet e Sistemeve Keystone dhe PSSA për vitin 2019*).
- Praktika më e mirë për zgjedhjen e sistemimeve në kohën e testimit, është përdorimi rëndom i këtyre praktikave me nxënësit dhe dokumentimi i dobisë së përdorimit, përpara testimit. Nuk rekomandohet përdorimi i sistemimeve në testimet, në rastet kur ato nuk janë përdorur rregullisht.

Sistemimet që janë VETEM për Nxënësit EL

Janë të lejuara në mënyrë specifike tre sistemime *vullnetare* për nxënësit EL

- 1) Fjalor përkthimi Fjalë-Fjalë, pa përcaktime dhe **pa fotografi** shoqëruese ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone dhe Matematikë e Shkencë VETEM në PSSA (E vlefshme për të GJITHE EL pavarësisht numrit të viteve në USA)
- 2) Përkthyes të Kualifikuar ** ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone dhe Matematikë e Shkencë, në PSSA dhe nxitjet me shkrim në seksionin me shkrim të ELA PSSA (E vlefshme VETEM për EL që kanë më pak se tre vite në shkollat e USA)
- 3) Broshurat pyetje përgjigje në Spanjisht/Anglisht për testet ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone dhe Matematikë e Shkencë për PSSA (E vlefshme VETEM për EL që kanë më pak se tre vite në shkollat e USA)

SHËNIM: Të tre sistemimet e mësipërme për nxënësit EL- NUK janë për nxënësit e viteve të fundit.

***Për më tepër informacion rreth Sistemimeve dhe Veçorive të testeve, ndiqni linkun në vazhdim dhe shikoni seksionin e Sistemimeve në Testim, në anën e djathtë të faqes:**

<http://www.education.pa.gov/K-2/Assessment%20and%20Accountability/PSSA/Pages/default.aspx#.Vs9pU-aM7xM>

**Për rolin e përkthyesve dhe atyre me pamje shikoni në linkun e mësipërm dhe klikoni në 2019 Accommodations Guidelines for ELs.